

VENDIM
Nr. 791, datë 15.12.2021

**PËR SHPËRBLIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT E
FUNDVITIT 2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar shpërblehen financiarisht, për vitin 2021, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- a) familjet dhe individët përfitues të ndihmës ekonomike, të përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- b) individët përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- c) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
- ç) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, që llogariten në shumën 413 658 000 (katërqind e trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj